



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 336/2 Prot.

Tiranë, më 28 . 02 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 84, datë 28 . 02 . 2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 41 Regj., datë 13.03.2024, të shtetasit K. K, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, K. K, evidentohet problematika e lindur mes tij dhe subjektit kundrejt të cilit ka pretenduar se e ka diskriminuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve/DPT.

Subjekti ankues citon se: “Nga viti 2007 deri në vitin 2011 kam qenë në marrëdhënie pune me DPT. Kam punuar në Sektorin e Vlerësimit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, DRT/Elbasan. Më pas, në 2011, me anë të lëvizjes paralele jam emëruar në detyrën e Inspektorit në Sektorin e Verifikimit në Terren, detyrë të cilën e kam mbajtur deri në vitin 2013, periudhë kur jam pezulluar nga detyra. Gjatë kësaj periudhe nuk kam marrë asnjë propozim për rikthim në detyrë, pavarësisht se kisha statusin e nëpunësit civil.

Të drejtën e rikthimit në detyrë e kam fituar në të gjitha shkallët e gjyqësorit, por pavarësisht këtij fakti, DPT nuk më rikthen në detyrë, me pretendimin se nuk ka vende të lira, ndërkohë që kjo nuk është e vërtetë, pasi persona të tjerë si unë, që kanë fituar çështjet gjyqësisht i kanë rikthyer në punë, në DRT Elbasan, apo edhe kanë punësuar persona të tjerë me kontrata afatshkurtra.”

<sup>1</sup> Pa provuar apo dokumentuar se çfarë pretendon a shpjegon ankuesi me këtë shkak.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Në përfundim të parashtrimeve të paraqitura nëpërmjet ankesës së tij, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe zbatimin e vendimit të Gjykatës për rikthimin e tij në detyrë, pranë DRT Elbasan.

Pas depozitimit të ankesës pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues si dhe lidhur me provueshmërinë e pretendimit të tij për diskriminim.

Për këtë arsye, me datë 27.02.2024, subjekti ankues është kontaktuar nga Specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave, pranë KMD-së, dhe është informuar lidhur me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm, pra të elementëve formalë për vijimin e regjistrimit të ankesës së tij.

Nëpërmjet shërbimit postar ankuesi ka depozituar pranë KMD-së, formularin e ankesës, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare\_ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr.

10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

***Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:***

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune pranë DRT Elbasan dhe me Vendimin nr. 2023, datë 13.07.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është konfirmuar si nëpunës civil dhe ka punuar në pozicionin e punës Inspektor i Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren, pranë DRT Elbasan.

Me vendimin nr. 1358, datë 25.03.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ankuesi është liruar nga detyra, me motivacionin e ristrukturimit të institucionit.

Subjekti ankues duke mos qenë dakord më këtë vendimmarrje, e ka kundërshtuar atë në rrugë administrative fillimisht, pranë Komisionit të Shërbimit Civil, i cili me vendimin nr. 115, datë 31.05.2013 ka vendosur:

- “1. Pranimin e ankesës së z. K. K.*
- 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 1358, datë 25.03.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve “Për lirim nga detyra”.*
- 3. Rikthimin e ankuesit në detyrën e mëparshme, Inspektor i Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren, pranë DRT Elbasan.*
- 4. Detyrimin e DPT, t’i paguajë ankuesit pagën e plotë për të gjithë periudhën e qëndrimit pa punë, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës e deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.*
- 5. Të njoftohen për këtë vendim, ankuesi K. K dhe Drejtori i Përgjithshëm të Tatimeve.*
- 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda afateve ligjore.”*

Vendimmarrja e mësipërme është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë, i cila nëpërmjet Vendimit nr. 90, datë 31.10.2013, ka disponuar lënien në fuqi të Vendimit nr. 115, datë 31.05.2013, të Komisionit të Shërbimit Civil.

Kundër vendimit të mësipërm, të Gjykatës së Apelit Tiranë, DPT, ka ushtruar rekurs pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi.

Nëpërmjet Vendimit nr. 170, datë 28.03.2017, Gjykata e Lartë, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 90, datë 31.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.”

Në arsyetimin e tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, *inter alia*, citon se:

*“... me të drejtë Gjykata e Apelit ka arsyetuar që DPT, nuk ka respektuar kushtet dhe procedurat e trajtimit dhe të mbrojtjes së garancive që ligji i njej nëpunësit civil edhe në rastin e ristrukturimit të institucionit.*

*Së pari, DPT, nuk i ka ofruar paditësit K. K, një vend të të njëjtit nivel ose në pamundësi, një vend të një niveli më të ulët brenda institucionit, si dhe nuk ka kryer veprimet e nevojshme të komunikimit me organet kompetente për ofrimin atij të një pozicioni pune të të njëjtit nivel ose në pamundësi, një vend të një niveli më të ulët në ndonjë institucion tjetër.*

*Së dyti, DPT, i ka ndërprerë në mënyrë të njëanshme dhe abuzive paditësit K. K përfitimet që ligji i njej atij për një periudhë një vjeçare, pra, për aq kohë sa ligji i kërkon institucioneve të ndërmarrin të gjitha masat deri sa nëpunësit civil t'i jetë ofruar një pozicion tjetër pune.*

*Së fundmi, sikurse është provuar nga gjykimi në fakt, jo vetëm që paditësit nuk i është ofruar ndonjë pozicion pune i të njëjtit nivel apo i një niveli më të ulët, por në institucionin ku ai kryente detyrën, pra në DRT Elbasan, pala e paditur, DPT, ka punësuar persona të tjerë, akoma më tepër, persona që nuk kanë statusin e nëpunësit civil.*

*Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ vjen në përfundimin që Gjykata e Apelit ka zbatuar drejt ligjin kur ka vlerësuar si të bazuar në prova dhe ligj, vendimin e Komisionit të Shërbimit Civil, me të cilin ishte pranuar ankimi i paditësit K. K, duke e shfuqizuar Vendimin nr. 1358, datë 25.03.2013, të DPT, rikthimin e paditësit në detyrë dhe detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit pagën deri në ekzekutimin e vendimit të rikthimit të tij në detyrë.”*

Referuar shkresës me nr. 24219 prot., datë 15.12.2020, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/MFE, evidentohet se, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, DPT, ka ngritur Komisionin e Posaçëm për shqyrtimin e kërkesave të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në këtë shkresë, ndër të tjera, citohet se: “Në mbledhjen e datës 10.12.2020, Komisioni i Posaçëm, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës për ekzekutim të vendimit të formës së prerë, për z. K. K, ka vlerësuar për të, sistemimin në pozicionin Inspektor i Dytë, Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, në DRT Tiranë, kategoria e pagës IV-a, në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë me nr. 90, datë 31.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë.”

Bazuar në sa më sipër, me shkresën me nr. 5780/2 prot., datë 26.10.2021, të Departamentit të Administratës Publike/ DAP, z. K. K është emëruar nëpunës civil, në pozicionin Inspektor i Dytë, Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, në DRT Tiranë, kategoria e pagës IV-a.

Bazuar në këqyrjen e korrespondencës shkresore ndërmjet ankuesit dhe DPT, DRT Elbasan, DAP, evidentohet se, z. K, u ka komunikuar institucioneve respektive mosdakordësinë e tij, lidhur me sistemin e tij në pozicionin e ofruar, pranë DRT Tiranë, duke parashtruar se bie

ndesh me Vendimin nr. 90, datë 31.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nëpërmjet të cilit DPT, urdhërohet për rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm në DRT Elbasan.

Po ashtu, përveç sa më sipër, ankuesi ka shprehur dhe arsyet e tij familjare se përse nuk mund të pranojë këtë emërim pranë DRT Tiranë, në një qytet tjetër nga ai i vendbanimit të tij.

Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesi, rezulton se, pretendimet për zbatimin e drejtë të vendimit gjyqësor të formës së prerë ai i ka parashtruar pranë punëdhënësit të tij, DPT, si dhe institucioneve kompetente.

Nga informacioni dhe aktet e përcjella nga ankuesi, nuk evidentohet të jetë ndjekur prej tij, kërkimi i zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë (Vendimi nr. 90/2013, i Gjykatës të Apelit Tiranë) sipas procedurës së përcaktuar në ligj, përmes Përmbauesit Gjyqësor.

Z. K ka kërkuar pranë KMD-së, që të zbatohet vendimi gjyqësor i mësipërm, i formës së prerë, dhe të konstatohet diskriminimi i tij nga ana e DPT-së, lidhur me faktin e mosekzekutimit të drejtë të tij.

➤ Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, Komisioneri vëren se:

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim, K.Pr.C), në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se, janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni: “...a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmbajnë një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;”

Në nenin 515 dhe 524, të tij, K.Pr.C, ka përcaktuar se, në rastet e moszbatimit vullnetar të vendimeve të formës së prerë të gjykatës: “Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbaues gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbauesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbauesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit”.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor”, i ndryshuar, në nenin 2<sup>3</sup>, të tij, ka përcaktuar se: “1. Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

2. Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbauesve gjyqësorë”.

---

<sup>3</sup> Objekti i veprimtarisë

Pika 1, e nenit 5<sup>4</sup>, të këtij Ligji përcakton se: *“Përmbaruesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.*

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përmbaruesi gjyqësor.

Gjatë ndjekjes së procedurës së ekzekutimit vullnetar të vendimit sipërcituar, në kushtet kur ai nuk ka ndodhur, pas kalimit të afatit për ekzekutim vullnetar, përmbaruesi gjyqësor fillon procedurën për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit.

Pra, në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues mund të kërkojë ekzekutimin e vendimit të formës së prerë (të paekzekutuar ende) me nr. 90, datë 31.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor.

Lidhur me sa më lart, subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e ish-punëdhënësit/DPT-së, lidhur me faktin e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, që në muajin nëntor 2013, kur i është komunikuar dhe njohur me të.

Në kontekst të sa më sipër, ankuesi ka marrë dijeni për moszbatimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës të Apelit Tiranë, lidhur me rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës (fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që gjatë vitit 2013 (apo dhe në vitin 2021 kur është emëruar pranë DRT Tiranë<sup>5</sup>, kur bazuar në komunikimet shkresore mes tij dhe të ish-punëdhënësit/DPT, ka konsideruar vendimin si të pazbatuar, dhe për këtë arsye, ka refuzuar vendin e punës pranë DRT Tiranë (emërimi i datës 26.10.2021) dhe ka kërkuar zbatimin e drejtë të vendimit të formës së prerë të Gjykatës.) Komisioneri vlerëson muajin nëntor 2013, si momentin e parë të marrjes dijeni për moszbatimin e tij, pasi ky vendim vijon të mbetet i paekzekutuar edhe aktualisht pas gati 11 vitesh, nga marrja e formës së prerë të tij.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se *“Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”*, ankesa e shtetasit K. K, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 13.03.2024, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni.

<sup>4</sup> Përmbaruesi gjyqësor.

<sup>5</sup> Mbështetur në shkresën me nr. 5780/2 prot., datë 26.10.2021, të DAP.

Pra, konkludojmë se janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri vëren se, bazuar në ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile (KPC-së) me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 05.11.2017, lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, individët e prekur drejtpërdrejtë, mund t’i drejtohen Gjykatës së juridiksionit të zakonshëm, si në rastin konkret, subjekti ankues, ka të drejtë t’i drejtohet asaj për konstatimin e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë në afat të arsyeshëm, si dhe për dëmshpërblim për mosekzekutim në afat të arsyeshëm dhe mohimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar, në nenet 399/1, e vijues të tij, përcakton si më poshtë vijon:

Neni 399/1<sup>6</sup>

“1. Në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit të përcaktuar në këtë kre, hyjnë edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

2. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve.”

Neni 399/2<sup>7</sup>

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

....

c) në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;

2. Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6 pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit.”

Neni 399/3<sup>8</sup>

“1. Shpërblimi i drejtë për shkeljen e afatit të arsyeshëm do të konsiderohet njohja e shkeljes, çdo masë e marrë për të përshpejtuar procedurat e hetimit, gjykimit të çështjes dhe të ekzekutimit të vendimit, dhe/ose shpërblimin e dëmit, sipas përcaktimeve të këtij kreu.

<sup>6</sup> Objekti.

<sup>7</sup> Afati i arsyeshëm.

<sup>8</sup> Shpërblimi i drejtë.

2. Cilido që është i përfshirë në një proces ligjor, në cilësinë e palës në proces, ka të drejtë shpërblimin e drejtë, siç përcaktohet nga ky nen.”

Neni 399/4<sup>9</sup>

“1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas nenit 399/6, pika 1, e këtij kreu. Sipas rastit në gjykim gjykata merr informacion nga organi i cili po zhvillon procedurat.

2. Kërkesëpadia, sipas nenit 399/6, pika 3, i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë kompetente, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm pasi procedura e konstatimit të shkeljes dhe përshpejtimin të procedurës është ezauruar sipas pikës 1, të këtij neni, dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni...”

Neni 399/5<sup>10</sup>

“1. Kërkesa depozitohet në sekretarinë e gjykatës që është në vonesë, ose gjykatës kompetente për ekzekutimin. Kërkesa duhet të përmbajë:

a) palët ndërgjyqëse, organin që pretendohet se ka kryer shkeljen, objektin e mosmarrëveshjes ose të ekzekutimit;

b) paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;

c) shkaqet për të cilat kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave;

ç) masat që kërkohen të merren.

2. Bashkë me kërkesën duhet të depozitohen edhe:

a) aktet me të cilat provohet tejkalimi i afatit të arsyeshëm;

b) procesverbale dhe vendime të ndërmjetme;

c) aktet e praktikës përmbare, sipas rastit;

ç) prokura, nëse kërkesa është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit.”

Neni 399/6<sup>11</sup>

“1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile ose administrative si më poshtë:

.....

ç) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është në procedurë ekzekutimi, kërkesa gjykohet nga gjykata e shkallës së parë, kompetente për ekzekutimin, sipas rregullave në fuqi.

2. Kur ka një vendim të formës së prerë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurës, subjekti kërkues mund të paraqesë padi për shpërblimin e dëmit, sipas pikës 3 të këtij neni.”

Neni 399/8<sup>12</sup>

“1. Pas shqyrtimit të kërkesës gjykata vendos:

a) pranimin e kërkesës, konstatimin e shkeljes dhe urdhërimin e ndërmarrjes brenda afateve të

<sup>9</sup> Kompetenca për shqyrtimin e kërkesës ose kërkesëpadiës.

<sup>10</sup> Paraqitja e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.

<sup>11</sup> Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës ose kërkesëpadiës.

<sup>12</sup> Marrja e vendimit.



veprimeve të caktuara procedurale gjatë gjykimit ose ekzekutimit;  
b) rrëzimin e kërkesës.

2. Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë.”

Neni 399/9<sup>13</sup>

“1. Gjykata vendos pranimin e kërkesës, kur vërtetohet shkelja e afatit të arsyeshëm, sipas nenit 6/1, të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

2. Në përcaktimin e shkeljes gjykata vlerëson kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e palëve dhe të trupit gjykues gjatë gjykimit, ose të përmbaruesit, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen.”

Neni 399/10<sup>14</sup>

“1. Pas shqyrtimit të kërkesëpadisë gjykata vendos shpërblimin e dëmit nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, për çdo vit, ose muaj në raport me vitin, përtej afatit të arsyeshëm.

2. Shpërblimi i dëmit bëhet duke mbajtur parasysh:

a) vështirësinë e procesit, në të cilin është verifikuar shkelja;

b) sjelljen e trupit gjykues ose përmbaruesit dhe të palëve;

c) natyrën e interesave në çështje;

ç) vlerën dhe rëndësinë e çështjes në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes ose ekzekutimit, e vlerësuar edhe në raport me kushtet personale të palëve.

3. Masa e shpërblimit të dëmit nuk mund të kalojë objektin e padisë ose të ekzekutimit.”

Neni 399/11<sup>15</sup>, përcakton se: “Udhëzimet dhe konkluzionet e gjykatës më të lartë, të dhëna gjatë shqyrtimit të kërkesës, sipas nenit 399/6, pika 1, janë të detyrueshme, për gjykatën që shqyrton çështjen në themel ose organin, i cili po kryen ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.”

Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm.

Në rastin në shqyrtim, Komisioneri konstaton se, ankuesi nuk ka depozituar prova që të dëshmojnë se i ka përdorur këto mjete ligjore të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, për të mbrojtur të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për këtë arsye, në lidhje me këto pretendime, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion.

Për rrjedhojë, në këto kushte, ankuesi mund t'i drejtohet gjykatës kompetente<sup>16</sup> lidhur me pretendimin e tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si

<sup>13</sup> Pranimi i kërkesës.

<sup>14</sup> Përmajtja e vendimit për shpërblimin e dëmit.

<sup>15</sup> Zbatimi i detyrueshëm i udhëzimeve.

<sup>16</sup> Neni 399/4, i KPC-së: “Kompetenca për shqyrtimin e kërkesës ose kërkesëpadisë”

rrjedhje e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga viti 2013 e deri aktualisht (*Referuar Vendimit nr. 90, datë 31.10.2013, të Gjykatës të Apelit Tiranë*).

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, Komisioneri vëren se, gjithashtu ky pretendim nuk qëndron, bazuar në arsyetimin e mëposhtëm:*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe të mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këtë shkak.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë, të padrejtë e të pafavorshëm të tij nga ana e DPT-së, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këtë shkak, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë një apo më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, është “çdo shkak tjetër”.

---

*“1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas nenit 399/6, pika 1, e këtij kreu. Sipas rastit në gjykim gjykata merr informacion nga organi i cili po zhvillon procedurat.*

*2. Kërkesëpadia, sipas nenit 399/6, pika 3, i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë kompetente, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm pasi procedura e konstatimit të shkeljes dhe përshpejtimin të procedurës është ezauruar sipas pikës 1, të këtij neni, dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni...”*

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh<sup>17</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh<sup>18</sup>.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturë të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim. Pastaj, barra e provës i bartet të

<sup>17</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë.....ose me çdo shkak tjetër.”

<sup>18</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë.

Komisioneri vlerëson se, diskriminimi<sup>19</sup> karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri gjykon se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Kjo pasi, ankuesi nuk ka arritur të provojë apo dokumentojë atë. Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosegzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Pala ankuese nuk parashtroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të provonin shkakun e mbrojtur nga LMD.

Komisioneri vëren se, *në parim*, vetëm pasi subjekti ankues *provon* para KMD-së se mbart e posedon shkakun e pretenduar, atëherë Komisioneri vihet në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e strukturave të punëdhënësit.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “b” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...b) ... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”.

---

<sup>19</sup> “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/dh, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, K. K, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar<sup>20</sup>.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>20</sup> Për analogji, nga praktika e KMD-së, citojmë: Vendimin nr. 81/2022, Vendimin nr. 117/2022, Vendimin nr. 51/2023.